



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë: 22 shkurt 2016

THIRRJE PËR PROPOZIME
Për organizatat e shoqërisë civile

Thirrje për Projekt-Propozime

Duke pasur parasysh rolin e komunave si zbatues të reformave nga fusha e vetëqeverisjes lokale si dhe rolin e pazëvendësueshëm të organizatave të shoqërisë civile në proces të avancimit të vetëqeverisjes lokale, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), në vazhden e aktiviteteve për implementimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale shpallë thirrjen për propozime për projektet e OJQ-ve.

Projekt propozimet duhet të paraqesin përkushtimin e organizatave të shoqërisë civile për të rritur bashkëpunimin dhe partneritetin me komunat sa i përket implementimit të strategjisë për vetëqeverisje Lokale 2016-2026.

Projektet propozimet duhet të trajtojnë objektivat e strategjisë dhe përfshijnë fushat si vijon:

- Rritja e qëndrueshmërisë fiskale të komunave dhe zhvillimi ekonomik lokal;
- Qeverisja e mirë (e-qeverisja, legjislacioni);
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të komunave;
- Rritja e partneritetit ndërmjet komunave, OJQ-ve dhe Bizneseve;
- Promovimi i diversitetit natyror dhe kulturor në komuna.

MAPL fton të gjitha organizatat e shoqërisë civile të cilat nga fushëveprimtaria e tyre i mbulojnë fushat e sipërhënuara, që të paraqesin projekt-propozimet, të cilat duhet të dorëzohen në MAPL dhe plotësojnë kriteret si vijon:

- Projekt Propozimi duhet të marrë në konsideratë orientimet strategjike të paraqitura në Strategjinë për vetëqeverisje Lokale 2016-2016 si dhe planin për implementimin e strategjisë;

- Projekt-propozimi duhet ta përfshijë qëllimin dhe aktivitetin e projektit;
- Buxhetin e detajuar,
- Afatin kohor për implementim dhe vendin;
- Përshkrimin e përfituesve dhe pjesëmarrësve
- Përshkrimin e kapaciteteve menaxhuese të organizatës,
- Xhirollogarinë e organizatës në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;
- Certifikatën e regjistrimit
- Kopjen e numrit fiskal;
- Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të projektit;
- Raportin mbi gjendjen financiare të OJQ-së përgjatë dy viteve të fundit.

Të gjitha dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur, në adresë të MAPL-së në Prishtinë (ndërtesa e re Qeveritare ish-Rilindja, kati përdhese, zyra e Arkivit të MAPL-së)

Ftesa do të jetë e hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Për informata shtesë, mund t'i referoheni faqes zyrtare të internetit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal: <https://mapl.rks-gov.net/>

.....